



Viti i VII-të i Botimit, Nr.1,
Qershorë 2016

PËRCAKTUESIT MAKROEKONOMIKË DHE BANKARË TË PËRFITIMIT TË BANKAVE NË SHQIPËRI

Fatmira Kola*, Erjon Sula**

***Fakulteti Ekonomik, Albanian University**

****Fakulteti Ekonomik, Universiteti Metropolitan**

Adresë kontakti: fatmirakola@gmail.com

Përmbledhje

Sektori bankar ka një rol kyç në zhvillimin ekonomik të një vendi. Ekonomitë e vendeve në zhvillim karakterizohen nga kërkesa e lartë për kredi duke rritur investimet. Rritja e kreditimit gjeneron të ardhura nga interesat për bankat. Këto të ardhura janë edhe më të larta në rastet kur tregu karakterizohet nga risk i lartë për shkak të lidhjes - risk i lartë kthim i lartë. Pavarësisht nivelit të konkurrencës së lartë, për shkak të numrit të lartë të bankave në krahasim me numrin e popullsisë, gjatë këtyre viteve fitimet e bankave paraqiten relativisht ndër më të lartat në rajon. Një rënie e të ardhurave vihet re kohët e fundit për shkak të shpenzimeve të larta për provigjone, të cilat ulin fitimet e bankave. Për të identifikuar faktorët që kanë ndikuar në përfitueshmërinë e bankave, kemi marrë në studim variablat makroekonomike dhe bankarë për një periudhë 13-vjeçare, duke filluar nga tremestri i parë i 2002 deri në tremestrin e katërt të 2014. Modeli është testuar nëpërmjet softuerit STATA.

Fjalë çelës: Menaxhim risku, Kreditim, Bank, Performance, Investime.

MACROECONOMIC AND BANK-SPECIFIC DETERMINANTS OF PROFITABILITY IN ALBANIA

Abstract

The banking sector has a key role in the economic development of each country. The economies of developing countries like Albania are characterized by high demand for credit due to increasing investment. Crediting growth generates interest income for banks. These revenues are even higher when the risk is greater because of high risk leads to high returns. Despite competition, there are very few competing banks, which lead to higher profits due to a lack of consumer options. A recent decline in revenue was observed due to higher provisioning expenses, which reduce banks' profits. To identify factors affecting profitability, the banks have got to study macroeconomic and microeconomic variables for a period of 13 years starting from the first trimester of 2002 to the fourth trimester of 2014. The model is tested and validated through STATA software.

Keywords: Risk Management, Credit, Bank, Performance, Investment.

1. Hyrje

Kalimi nga një ekonomi e centralizuar në ekonomi tregu në Shqipëri, u shoqërua me ndryshime rrënjësore në sistemin bankar nga viti 1992 deri në ditët e sotme. Në vitin 1992 ka qenë vetëm 3 banka shtetërore që operonin. Aktualisht, në tregun shqiptar operojnë 16 banka të nivelit të dytë. Bankat kanë një rol të për të rëndësishëm, pasi orientojnë paratë në drejtim të atyre që kanë më shumë nevojë, pa harruar dhe kontributin e tyre në ekonominë e një shteti. Banka është krijuar në bazë të një sistemi që ka për qëllim të merret me depozitat monetare, ruajtje të kursimeve të klientëve dhe huadhënien për qëllime financiare. Pavarësisht konkurrencës, edhe për shkak të numrit lartë të bankave në krahasim me numrin e popullsisë, normat e interesit të kredisë ndër këto vite paraqiten ndër më të lartat në rajon. Sistemi bankar në Shqipëri deri më sot nuk ka kaluar një krizë të pastër bankare. Kriza në sistemin financiar ka qenë kriza e vitit 1997, që shkaktoi shembjen e skemave piramidale në Shqipëri, luftën civile dhe humbjen e besimit në sistemin financiar, për një periudhë afatgjatë. Kriza financiare e 2007-2008 ka çuar në një rënie të nivelit të remitancave në Shqipëri. Direkt ose indirekt ul aftësinë paguese të konsumatorëve shqiptarë, pa lënë pas dore uljen e madhe të ritmit të rritjes ekonomike në Shqipëri. Shqipëria ka treguar një rritje pozitive të GDP-së në vitet e fundit, ndërsa norma bazë e interesit ka rënë në mënyrë të vazhdueshme, duke arritur në 1.25% dhe fitimet e bankave komerciale kanë qenë relativisht të larta. Ka pasur një rritje eksponenciale të totalit të kredive në një periudhë relativisht të shkurtër kohe, një fenomen që nuk është e zakonshme në vendet e tjera në rajon, e as në Evropë.

2. Rishikimi i literaturës

Qëllimi i këtij studimi është që të identifikojë faktorët që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave që operojnë në tregun shqiptar. Sipas literaturës, faktorët makroekonomikë që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave janë Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) dhe inflacioni. Rritja e PBB ka një efekt pozitiv në përfitimin e bankave, për shkak të rritjes së kreditimit. Rritja e PBB rrit kërkesën për investime, duke rritur kërkesën për produkte bankare dhe në këtë mënyrë rritet edhe përfitueshmëria e bankave (1).

Inflacioni: Përfshirja e inflacionit në analizën tonë na lejon të shohim nëse politika monetare ndikon në përfitimet bankare. Inflacioni mund të ndikojë si në shpenzimet, edhe në ardhurat e çdo organizate, duke përfshirë bankat. Ekziston një lidhje ndërmjet inflacionit dhe kthimit mbi aktivin gjithsej (ROA) dhe kthimit ndaj kapitalit të pronarit (ROE) (2).

Borxhi publik: Deficiti buxhetor të sektorit publik ka efekt pozitiv si tek ROE, ashtu edhe tek ROA (3).

Faktorët bankarë të rëndësishëm janë: Madhësia e kapitalit: Madhësia e një banke mund të ndikojë pozitivisht në fitimin e bankave (4). Së pari, bankat me asete të larta përfitojnë nga ekonomitë e shkallës. Së dyti, bankat më të mëdha mund të përfitojnë nga kompetencat e tyre në treg. Madhësia e kapitalit mund të ketë edhe impakt negativ për arsye burokratike dhe të tjera. “Për këtë arsye, marrëdhënia madhësi - profitabilitetit mund të pritet të jetë jo-lineare” sipas (5).

Kapitalizimi është raporti i kapitalit të pronarëve me totalin e aktiviteteve; vërteton se bankat e mirëkapitalizuara përballen me kosto më të ulët të financimit, dhe si pasojë, rrezik më të ulët të falimentimit. Ne presim një marrëdhënie negative midis raportit të kapitalit të pronarit dhe aktiveve gjithsej dhe rrezikut të falimentimit dhe bashkëshoqërimi pozitiv me profitabilitetit. Norma e mjaftueshmërisë (raporti i kapitalit ndaj totalit të aktiveve). Një aftësisë paguese e lartë mund të ketë një efekt pozitiv në performancën duke reduktuar rreziqet e marra nga banka, por nga ana tjetër, aftësia paguese e lartë do të zvogëlojë efektin e levave, duke rritur kostot e financimit.

Sipas literaturës, vihet re një lidhje negative midis raportit të kredive me probleme ndaj total portofolit të kredive dhe fitimit të bankave (6). Pavarësisht politikave të ndryshme nga ana e bankës qendrore dhe qeverisë, niveli i kredive të këqija është në rritje dhe shpall mungesën e likuidimit të bizneseve private. Aktualisht, raporti NPL në sistemin bankar shqiptar është më i larti në rajon, duke treguar një tendencë në rritje dhe një rrezik më të lartë të kredisë mbi të gjitha. Zyrtarisht, Banka e Shqipërisë ka konfirmuar se “në tremujorin e dytë të vitit 2014, kreditë me probleme në portofolet e bankave në Shqipëri ishte 23.9% ose 69 miliardë lekë (670 milionë USD). Ndër variablat specifike bankare që ndikojnë fitimin e bankave, është dhe raporti midis kredive dhe depozitave, duke paraqitur cilësinë e bankave në menaxhimin e depozitave në dhënien kreditimin e bizneseve dhe individëve.

3. Të dhënat dhe metodologjia


Qëllimi i këtij studimi është të hetojë faktorët që ndikojnë në fitimet e bankave në Shqipëri. Në këtë studim do të përdoren të dhënat në nivelin mikro dhe makroekonomik. Të dhënat makroekonomike janë marrë nga instituti kombëtar i statistikave (INSTAT) dhe i Bankës së Shqipërisë. Të dhënat në nivelin mikro janë marrë nga raportet e bankave të nivelit të dytë, Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) dhe Banka e Shqipërisë. Si variabël e varur do të jenë raportet e përfitueshmërisë ROA (kthimi ndaj aktiveve gjithsej) dhe ROE (kthimi nga kapitali i pronarit), variabël të pavarur do të jenë faktorët makroekonomikë dhe mikroekonomikë. Të dhënat e marra në studim janë me frekuencë tremujore për një periudhë kohore prej 13 vite, duke filluar nga tremujori i parë i vitit 2002 deri në tremujorin e katërt të vitit 2014. Në total janë marrë në studim 789 observime, duke marrë në studim 16 bankat që operojnë në tregun shqiptar. Paneli i marrë në studim është i paekuilibruar, pasi 16 bankat që operojnë në tregun shqiptar e kanë filluar aktivitetin në periudha të ndryshme kohore. Të dhënat panel-paekuilibruar përfshijnë më shumë vërejtje dhe rezultatet e tyre janë më pak të varura në një periudhë të caktuar (7). Shpërndarja e vëzhgimeve për bankat që operojnë në sistemin bankar shqiptar është paraqitur në Tabelën më poshtë.

Tabela 1. Shpërndarja e vëzhgimeve për bankat që operojnë në sistemin bankar shqiptar

	Emri i Bankës	Numri i observimeve
1	Alpha Bank	51
2	Credins Banks	47
3	United Bank of Albania	49
4	Credit Bank of Albania	43
5	First Investments Bank	52
6	Emporiki Bank	52
7	National Bank of Greece (NBG)	52
8	National Commercial Bank (BKT)	52
9	International Commercial Bank	52
10	Societe Generale Albania	43
11	ProCredit Bank	52
12	Raiffeisen Bank sh.a	52
13	Tirana Bank	52
14	Union Bank	36
15	Veneto Bank	52
16	Intesa San Paolo Bank Albania	52


ROE është një tregues i përfitueshmërisë që demonstroi sa fiton bankat në raport me investimet e aksionarëve. Kthimi nga kapitali i vet për bankat e nivelit të dytë që operojnë në tregun shqiptar paraqiten si në vijim.

Grafiku Nr. 1. Kthimi ndaj kapitalit vet për 16 bankat gjatë Q1: 2002-Q42014



Burimi: Shoqata e Bankave dhe raportet e bankave të nivelit të dytë

Grafiku Nr. 2. Kthimi nga aktivet gjithsej për 16 bankat gjatë Q1: 2002-Q42014



Burimi: Shoqata e Bankave dhe raportet e bankave të nivelit të dytë

Në grafikun nr. 2 paraqitet kthimi nga aktivet gjithsej (ROA), i cili demonstroi aftësinë e menaxhimit të një banke për të gjeneruar fitime nga asetet e saj. Sa më i lartë të jetë ky raport, aq më e lartë është përfitueshmëria e bankave. ROA është raport i dobishëm për të krahasuar rentabilitetin e një banke me bankat konkurrense ose të gjithë sektorin bankar.

4. Rezultate dhe përfundime

Për të studiuar modelin kemi përdorur softuerin STATA. Variablat që kemi marrë në studim ndahen në variabla makroekonomikë dhe specifike bankarë. Variablat makroekonomikë të marrë në studim janë: norma e rritjes së prodhimit të brendshëm bruto, raporti i borxhit publik ndaj prodhimit të brendshëm bruto dhe norma e inflacionit. Variablat specifike bankarë të marrë në studim janë: niveli i kredive me probleme, i shprehur si raport i kredive me probleme ndaj total portofolit të kredisë. LTD është raporti i total kredive ndaj total depozitave, i cili është matës i likuiditetit. Kapitalizimi (*Capitalization*) është shprehur si raport i kapitalit të pronareve dhe total aseteve. Modeli i marrë në studim i shprehur në funksion ka formën e mëposhtme:

$$ROE = \beta_0 + \beta_1 GDP_{growthrate,t} + \beta_2 DEBTGDP_{t-1} + \beta_3 INFL_{rate,t} + \beta_4 NPL_{t,t} + \beta_5 CAP_{t,t} + \beta_6 LTD_{t,t} + \eta + \epsilon_{i,t}$$

Të njëjtët variabla të pavarur janë marrë në studim për të studiuar ndikimin e tyre te kthimi nga aktivet gjithsej.

$$ROA = \beta_0 + \beta_1 GDP_{growthrate,t} + \beta_2 DEBTGDP_{t-1} + \beta_3 INFL_{rate,t} + \beta_4 NPL_{t,t} + \beta_5 CAP_{t,t} + \beta_6 LTD_{t,t} + \eta + \epsilon_{i,t}$$

Kthimi nga kapitali i pronarit dhe kthimi nga aktivet gjithsej janë variabla të varur në varësi të rritjes së PBB, borxhit publik, inflacionit, kredive me probleme, kapitalizmit (*capitalization*) dhe raporti kredi me depozita. Në tabelën 2 paraqiten rezultatet e studimit.

Tabela Nr. 2. Rezultatet e studimit sipas për ROE dhe ROA

	ROE	ROA
GDPgrowthrate	0.041* (2.04)	0.279 (1.08)
DEBTGDP	0.055* (1.92)	0.407 (-0.83)
INFLrate	0.556 (-0.59)	0.529 (-0.63)
NPLTotalLoans	0.000*** (-9.97)	0.081* (-1.75)
LTD	0.000*** (-5.85)	0.059* (-1.89)
Capitalization	0.036* (-2.10)	0.001*** (3.41)

Burimi: rezultatet e llogaritura nga autorët (* tregon rëndësinë e rezultatit, ku ***** është e rëndësishme në 10% dhe * në 1%)

Sipas rezultateve të paraqitura, vihet re një lidhje pozitive midis rritjes së Prodhimit të Brendshëm dhe kthimit nga kapitali i vet. Kjo lidhje pozitive është e rëndësishme, duke vërtetuar se edhe për ekonominë shqiptare rritja e PBB ndikon pozitivisht në ekonominë e vendit duke rritur kreditimin dhe fitimin e bankave. Ky raport rezulton me shenjë pozitive edhe me kthimin nga aktivet gjithsej, por nuk është i rëndësishëm si për kthimin nga kapitali i pronarit.

Sipas rezultateve të paraqitura, vihet re një lidhje pozitive midis borxhit publik dhe kthimit nga kapitali i vet. Midis borxhit publik dhe kthimit nga aktivet gjithsej, ekziston një lidhje negative dhe e parëndësishme. Midis inflacionit dhe raporteve të përfitueshmërisë, vërehet një lidhje negative dhe e parëndësishme për tregun shqiptar.

Ekziston një lidhje negative midis raportit të kredive me probleme raporteve të përfitueshmërisë. Niveli i lartë i kredive me probleme gjeneron shpenzime për provigjone, duke ulur në këtë mënyrë fitimet e bankave. Shpenzimet për provigjone kanë qenë shkaktari kryesor i uljes së fitimeve vitet e fundit.

Sipas rezultateve, raporti kredi ndaj depozitave dhe raporteve të përfitueshmërisë ka një lidhje negative dhe të rëndësishme.

Midis kapitalizimit dhe ROE ekziston një lidhje negative dhe e rëndësishme. Kjo lidhje është e vërtetuar edhe në literature, ku asetet më të larta totale jo domosdoshmërisht çojnë në fitime më të larta për shkak të disekonomive të shkallës dhe nivelit më të lartë të kredive të cilat të kontribuojnë në drejtim të përfitueshmërisë. Kjo lidhje është pozitive për kthimin nga aktivet gjithsej, duke vërtetuar studimet empirike sipas të cilave madhësia e bankave lidhet me ekonominë e shkallës, pritet të ketë një lidhje pozitive midis madhësisë së bankës dhe përfitueshmërisë (8).

Referenca

1. Bikker, J. A. & Hu, H. 2002, "Cyclical patterns in profits, provisioning and lending of banks and procyclicality of the new Basel capital requirements", BNL Quarterly Review, vol. 221, pp. 143-175.
2. Short, B. K. 1979, "The relation between commercial bank profit rates and banking concentration in Canada, Western Europe and Japan", Journal of Banking and Finance, vol. 3, pp. 209-219.
3. Naceur, S. B., 2003. "The Determinants of the Tunisian Banking Industry Profitability: Panel Evidence". Universite Libre de Tunis Working Papers.
4. Goddard, J., Molyneux, P., Wilson, J. O. S., 2004. The profitability of European banks: a cross-sectional and dynamic panel analysis. Manchester School 72 (3), 363-381.
5. Athanasoglou, P.P., Brissimis, N. S., 2004. The effect of mergers and acquisitions on bank efficiency in Greece. Bank of Greece Economic Bulletin 22, 7-34.
6. Mansur, I., Zangeneh, H., Zitz, M. S., 1993. "The Association between Banks' Performance Ratios and Market-Determined Measures of Risk". Journal of Applied Economics 25, 1503-1510.
7. Rinaldi, L., Sanchis-Arellano, A., 2006. Household Debt Sustainability: What Explains Household Non-performing Loans? An Empirical Analysis. ECB Working Paper.
8. Berger, A.N., Hannan, T. H., 1989. The price-concentration relationship in banking. Review of Economics and Statistics 71, 291-299.

Sitografia

www.bankofalbania.com

www.aab.al